

Marrëveshja e Studimit

Çfarë është Marrëveshja e Studimit?

Marrëveshja e Studimit është një kontratë që përcakton detyrimet dhe të drejtat e dy Universiteteve kur zbatojnë një Projekt Shkëmbimi Afatshkurtër për Studentët.

Nëse Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, përfshihet në një Projekt Shkëmbimi Afatshkurtër për Studentët me një Universitet të Huaj dhe shpall thirrjen për këtë projekt, atëherë çdo student gjatë aplikimit në këtë thirrje duhet të dorëzojë dokumentet që pasqyrohen në thirrje si edhe të plotësojë Marrëveshjen e Studimit.

Më poshtë gjeni udhëzimet përkatëse për çdo tabelë përbërëse në tabelën e studimit. Për të qenë të qartë, çdo tabelë do të jepet dy herë; një herë e paplotësuar dhe një herë e plotësuar.

Shënim- Shembujt e marrë në tabelën e plotësuar janë të rastësishëm.

Udhëzimet për tabelën numër 1

Student	Last name(s)	First name(s)	Date of birth	Nationality ⁱ	Sex [M/F]	Study cycle ⁱⁱ	Field of education ⁱⁱⁱ
Sending Institution	Name	Faculty/Department	Erasmus code ^{iv} (if applicable)	Address	Country	Contact person name ^v ; email; phone	
Receiving Institution	Name	Faculty/ Department	Erasmus code (if applicable)	Address	Country	Contact person name; email; phone	

Tabela numër 1 përbëhet nga tre zëra: Student – Sending Institution – Receiving Institution

Zëri i parë- Student- { Student}

Në këtë zë ju duhet të paraqisni të dhënat tuaja personale, të cilat sipas renditjes së tabelës janë:

- Mbiemri
- Emri
- Data e lindjes
- Kombësia
- Gjinia
- Cikli i studimit
- Fusha e Studimit

Zëri i dytë- Sending Institution – {Institucioni Dërgues}

Institucioni dërgues quhet Universiteti në të cilin ju studioni, pra Universiteti i Mjekësisë, Tiranë. Ky zë plotësohet nga Koordinatori Akademik në nivel Fakulteti, i cili përzgjidhet nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Në këtë zë Koordinatori Akademik në nivel Fakulteti duhet të paraqesë të dhënat, të cilat sipas renditjes së tabelës janë:

- Emërtimi i institucionit që përfaqëson {UMT}
- Fakulteti të cilin përfaqëson
- Kodin e Erasmus+ { Vetëm Universitetet që i përkasin vendeve të BE-së kanë një kod të tillë; në rastin e UMT-së kjo e dhënë plotësohet përmes një vize {-}.
- Adresa e Institucionit { UMT-së}
- Shteti
- Emër dhe mbiemri. Adresa e postës telefonike dhe numri i telefonit.

Shënim- Studenti nuk e plotëson këtë zë, pasi e plotëson Koordinatori Akademik në nivel Fakulteti.

Koordinatorët Akademikë në nivel Fakulteti në Universitetin e Mjekësisë

Koordinatorët akademikë në nivel Fakulteti në Universitetin e Mjekësisë janë:

- Dr.Shk. Durim Çela për Fakultetin e Mjekësisë
- Prof.Virgjini Mulo për Fakultetin e Mjekësisë Dentare
- Prof.Ass. Vjollca Shpata për Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike

Zëri i tretë- Receiving Institution {Institucioni Pritës}

Institucioni Pritës quhet Universiteti i Huaj, në të cilin ju do të shkoni të studioni dhe të kryeni periudhën e shkëmbimit. Ky zë plotësohet nga Përfaqësuesi i Universitetit të Huaj.

Në këtë zë Përfaqësuesi i Universitetit të Huaj duhet të paraqesë të dhënat të cilat sipas renditjes së tabelës janë:

- Emërtimi i institucionit që përfaqëson { Shembull:Università di Bologna }
- Fakulteti të cilin përfaqëson
- Kodin e Erasmus+ { Universitetet që ndodhen në vendet e BE-së apo që janë pjesë e programit Erasmus+ kanë një Kod përkatës}
- Adresa e Institucionit { Adresën e Universitetit të Bolonjës}
- Shteti
- Emër dhe mbiemri. Adresa e postës telefonike dhe numri i telefonit.

Shënim- Studenti nuk e plotëson këtë zë, pasi e plotëson Përfaqësuesi i Universitetit të huaj.

Shembull i Tabelës së Plotësuar

Student	Last name(s)	First name(s)	Date of birth	Nationality ^{vi}	Sex [M/F]	Study cycle ^{vii}	Field of education ^{viii}
	Gjata	Lara	06.12.1997	Albanian	Female	2 nd cycle	Medicine
Sending Institution	Name	Faculty/Department	Erasmus code ^{ix} (if applicable)	Address	Country	Contact person name ^x ; email; phone	
	University of Medicine, Tirana	Faculty of Medicine	-----	Adresa: Rruga e Dibrës , Nr. 369, Hyrja nr. 1, 1012 – Tiranë	Albania	Emri dhe mbiemri i Koordinatorit akademik në nivel fakulteti; adresa e postes elektronike; numri i telefonit	
Receiving Institution	Name	Faculty/ Department	Erasmus code (if applicable)	Address	Country	Contact person name; email; phone	

Udhëzimet për tabelën numër 2 ose tabelën A

Before the mobility			
<i>Study Programme at the Receiving Institution</i>			
Planned period of the mobility: from [month/year] to [month/year]			
Component code (if any) ^{xi}	Component title at the Receiving Institution (as indicated in the course catalogue ^{xii})	Semester	Number of ECTS credits (or equivalent) ^{xiii} to be awarded by the Receiving Institution upon successful completion
			Total: ...
Web link to the course catalogue at the Receiving Institution describing the learning outcomes: [<i>web link to the relevant information</i>]			

Tabela numër 2, është tabela, e cila duhet të plotësohet nga studenti, i cili duhet të përzgjedhë lëndët që do të ndjekë në Universitetin Pritës {Universitetin e Huaj} gjatë periudhës së shkëmbimit.

Në fillim të kësaj table duhet përcaktuar kohëzgjatja e periudhës së studimit, e cila do të përcaktohet sipas programit të lëndëve, që gjendet në linkun që Universiteti i Mjekësisë ka shfaqur për thirrjen për aplikim në Universitetin e Huaj.

Tabela numër 2 -përbëhet nga katër zëra: 1. Component Code- 2. Component title at the Receiving Institution – 3.Semester- 4. Number of ECTS credits to be awarded by the Receiving Institution upon successful completion.

Zëri i parë dhe i dytë- Component Code& Component title at the Receiving Institution {Kodi përfaqësues& Emërtimi i lëndës në Institucionin Pritës, pra në Universitetin e Huaj}.

Studenti pasi të ketë vizituar dhe shqyrtuar katalogun e lëndëve që zhvillohen në Universitetin e Huaj, do të përzgjedhë lëndët që do të ndjekë pranë këtij Universiteti gjatë periudhës së shkëmbimit dhe do t'i pasqyrojë këto të fundit sipas emërimit që ato kanë në katalogun e Universitetit Pritës duke i shoqëuar edhe me kodin përkatës.

Shembull – Nëse studenti vendos të ndjekë lëndën e Anatomisë së Njeriut në Universitetin e Huaj atëherë në zërin e parë do të shkruajë kodin përkatës të kësaj lënde { D0254} dhe në zërin e dytë- **Human Anatomy**.

Zëri i tretë- Semester

Pasi të ketë përzgjedhur lëndën që do të ndjekë në Universitetin e Huaj dhe ta ketë emërtuar këtë lëndë sipas emërimit në katalogun e këtij Universiteti shoqëruar me kodin përkatës, studenti duhet të pasqyrojë edhe semestrin kur zhvillohet kjo lëndë në Universitetin European.

Shembull- Nëse – Human Anatomy- zhvillohet në semestrin e parë atëherë studenti në këtë zë do të shkruajë 1.

Zëri i katërt- Number of ECTS credits to be awarded by the Receiving Institution upon successful completion { Kreditet që do t'i jepen studentit nga Institucioni Pritës, pra Universiteti i Huaj, pas përfundimit me sukses të periudhës së shkëmbimit}

Pasi të ketë përzgjedhur lëndën që do të ndjekë në Universitetin e Huaj dhe ta ketë emërtuar këtë lëndë sipas emërimit në katalogun e këtij Universiteti shoqëruar me kodin përkatës dhe të ketë pasqyruar se në cilin semester kryhet kjo lëndë, studenti duhet të pasqyrojë edhe kreditet e kësaj lënde sipas programit të lëndëve mësimore në Universitetin e Huaj.

Shembull - Nëse – Human Anatomy- zhvillohet në semestrin e parë dhe ka 11 kredite atëherë studenti në këtë zë do të shkruajë 11.

Shënim- Duke qenë se studenti do të përzgjedhë më shumë se 1 lëndë , në fund të tabelës në etiketën – Total- do të mbledhë të gjitha kreditet e lëndëve që ka përzgjedhur të kryejë gjatë periudhës së shkëmbimit në **Universitetin e Huaj**.

Në fund të tabelës, student duhet të pasqyrojë edhe linkun e Universitetit e Huaj në të cilin është bazuar për të plotësuar tabelën A.{ **Shembull**-www.bologna.it}

Shembull i tabelës së plotësuar

Before the mobility

Study Programme at the Receiving Institution

Planned period of the mobility: from [month/year] to [month/year]

Component code (if any) ^{xiv}	Component title at the Receiving Institution (as indicated in the course catalogue ^{xv})	Semester	Number of ECTS credits (or equivalent) ^{xvi} to be awarded by the Receiving Institution upon successful completion
DO254	Human Anatomy	1	11
D0258	Histology and Embryology	1	7
D4075	Biology	1	13
			Total:31

Web link to the course catalogue at the Receiving Institution describing the learning outcomes: www.bologna.it

Udhëzimet për tabelën numër 3

The level of language competence^{xvii} in _____ [indicate here the main language of instruction] that the student already has or agrees to acquire by the start of the study period is: A1 A2 B1 B2 C1 C2 Native speaker

Tabela numër 3 është një tabelë, e cila duhet të plotësohet nga studenti. Kjo tabelë tregon nivelin gjuhësor që studenti ka. Në këtë tabelë duhet specifikuar gjuha në të cilën studenti do t'i ndjekë lëndët në Universitetin e Huaj dhe niveli, në cilin, studenti e zotëron këtë gjuhë duke shënuar me kryq nivelin përkatës.

Shembull i Tabelës së Plotësuar

The level of language competence^{xviii} in **English** [indicate here the main language of instruction] that the student already has or agrees to acquire by the start of the study period is: A1 A2 **B1X** B2 C1 C2 Native speaker

Udhëzimet për tabelën numër 4 ose për tabelën B

Recognition at the Sending Institution

Table B Before the mobility	Component code (if any)	Component title at the Sending Institution (as indicated in the course catalogue)	Semester	Number of ECTS credits (or equivalent) to be recognised by the Sending Institution
				Total: ...

Provisions applying if the student does not complete successfully some educational components: *[web link to the relevant information]*

Tabela numër 4 ose tabela B është tabela, e cila duhet të plotësohet nga studenti në bashkëpunim me Koordinatorin Akademik në nivel Fakulteti në Universitetin e Mjekësisë, i cili, lëndët që ka vendosur të ndjekë në Universitetin e Huaj, duhet t'i pasqyrojë edhe me lëndët e barasvlershme në Universitetin e Mjekësisë, shoqëruar me kodin përkatës, semestrin kur zhvillohen këto lëndë dhe kreditet përkatëse të këtyre lëndëve. Emërtimi i lëndëve duhet të bëhet në gjuhën angleze.

Pra, nëse në Universitetin e Huaj ka vendosur të ndjekë disa lëndë, në tabelën B duhet të paraqesë se me cilat lëndë përkojnë në Universitetin e Mjekësisë.

Tabela numër 4 ose tabela B përbëhet nga katër zëra: 1. Component Code- 2. Component title at the Sending Institution – 3.Semester- 4. Number of ECTS credits to be awarded by the Sending Institution upon successful completion.

Zëri i parë dhe i dytë- **Component Code& Component title at the Sending Institution** {Kodi përfaqësues& Emërtimi i lëndës në Institucionin Dërgues, pra në Universitetin e Mjekësisë}.

Studenti pasi të ketë zgjedhur lëndët dhe pasqyruar të gjitha të dhënat e tyre në **Tabelën A sipas programit të lëndëve në Universitetin e Huaj**, duhet të plotësojë të dhënat për këto lëndë sipas programit të lëndëve në **Universitetin e Mjekësisë në Tabelën B**.

Shembull – Nëse studenti vendos të ndjekë lëndën e Anatomisë së Njeriut në Universitetin e Huaj, atëherë duhet të verifikojë se cili kod e përfaqëson këtë lëndë në programin e lëndëve në Universitetin e Mjekësisë.

Në zërin e parë do të shkruajë kodin përkatës të kësaj lënde **MP-101** dhe në zërin e dytë- **Human Anatomy**.

Zëri i tretë- Semester

Në këtë zë studenti do të shkruajë se në cilin semester zhvillohet lënda e përzgjedhur në Universitetin e Mjekësisë.

Shembull- Nëse – Human Anatomy- zhvillohet në semestrin e parë në Universitetin e Mjekësisë, atëherë studenti në këtë zë do të shkruajë 1.

Zëri i katërt- Number of ECTS credits (or equivalent) to be recognised by the Sending Institution { Kreditet që do t'i njihen studentit nga Institucioni Dërgues, pra nga Universiteti i Mjekësisë }

Në këtë zë studenti do të shkruajë se sa kredite ka lënda e përzgjedhur prej tij në Universitetin e Mjekësisë.

Shembull - Nëse – Human Anatomy- zhvillohet në semestrin e parë dhe ka 14 kredite, atëherë studenti në këtë zë do të shkruajë 14.

Shënim- Duke qenë se studenti do të përzgjedhë më shumë se 1 lëndë , në fund të tabelës në etiketën – Total- do të mbledhë të gjitha kreditet e lëndëve sipas katalogut të lëndëve në Universitetin e Mjekësisë.

Në fund të tabelës, studenti duhet të pasqyrojë edhe linkun e Universitetit të Mjekësisë, në të cilin është bazuar për të plotësuar tabelën B .{ www.umed.edu.al }

Shembull i Tabelës së Plotësuar

<i>Recognition at the Sending Institution</i>				
Table B Before the mobility	Component code (if any)	Component title at the Sending Institution (as indicated in the course catalogue)	Semester	Number of ECTS credits (or equivalent) to be recognised by the Sending Institution

MPE-101	Human Anatomy	1	14
MP-E 102	Histology and Embriology	1	8
MP- E	Biology	1	5
			Total: ...27
Provisions applying if the student does not complete successfully some educational components: www.umed.edu.al			

Vini re! Tabela B pasqyron të dhënat për lëndët sipas programit të lëndëve në Universitetin e Mjekësisë. Kjo tabelë plotësohet në bashkëpunim me Koordinatorin Akademik në nivel Fakulteti.

Tabela A pasqyron të dhënat për lëndët sipas katalogut të lëndëve në Universitetin e Huaj.

Udhëzimet për tabelën numër 5

Commitment					
By signing this document, the student, the Sending Institution and the Receiving Institution confirm that they approve the Learning Agreement and that they will comply with all the arrangements agreed by all parties. Sending and Receiving Institutions undertake to apply all the principles of the Erasmus Charter for Higher Education relating to mobility for studies (or the principles agreed in the Inter-Institutional Agreement for institutions located in Partner Countries). The Beneficiary Institution and the student should also commit to what is set out in the Erasmus+ grant agreement. The Receiving Institution confirms that the educational components listed in Table A are in line with its course catalogue and should be available to the student. The Sending Institution commits to recognise all the credits or equivalent units gained at the Receiving Institution for the successfully completed educational components and to count them towards the student's degree as described in Table B. Any exceptions to this rule are documented in an annex of this Learning Agreement and agreed by all parties. The student and the Receiving Institution will communicate to the Sending Institution any problems or changes regarding the study programme, responsible persons and/or study period.					
Commitment	Name	Email	Position	Date	Signature
Student			Student		
Responsible person ^{xxx} at the Sending Institution					
Responsible person at the Receiving Institution ^{xx}					

Tabela numër 5 është një tabelë përmes së cilës, Institucioni Dërgues, pra, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë dhe Institucioni Pritës, pra Universiteti i Huaj, miratojnë Marrëveshjen e Studimit duke pohuar se të gjitha lëndët dhe të dhënat mbi to janë në përputhje të plotë me programin e lëndëve në dy Universitetet.

Universiteti i Huaj, zotohet të mirëpresë studentin gjatë periudhës së përcaktuar për shkëmbimin.

Universiteti i Mjekësisë zotohet t'i njohë studentit kreditet për lëndët që ka kryer në Universitetin e Huaj pas periudhës së shkëmbimit.

Kjo tabelë përbëhet nga tre zëra; - Student- Responsible person at the sending institution; Responsible person at the receiving institution.

Zëri i parë- Student- Studenti

Në këtë zë studenti duhet të paraqesë të dhënat tuaja personale të cilat sipas renditjes së tabelës janë:

- Emër, mbiemër.
- Adresa e postës elektronike
- Pozicioni {Student}
- Data
- Firma

Zëri i dytë- Responsible person at the sending institution- Personi përgjegjës në Institucionin dërgues

Ky zë plotësohet nga Koordinatori Institucional. Në Universitetin e Mjekësisë Koordinatori Institucional është Zv. Rektori për Projektet dhe Marrëdhëniet me Jashtë, Prof. Alma Idrizi.

Koordinatori Institucional duhet të paraqesë të dhënat, të cilat sipas renditjes së tabelës janë:

- Emër, mbiemër.
- Adresa e postës elektronike
- Pozicioni (Student)
- Data
- Firma

Shënim- Studenti nuk e plotëson këtë zë, pasi e plotëson Koordinatori Institucional i Universitetit të Mjekësisë.

Zëri i tretë- Responsible person at the receiving institution- Personi përgjegjës në Institucionin Pritës

Në këtë zë Përfaqësuesi i Universitetit të Huaj duhet të paraqesë të dhënat të cilat sipas renditjes së tabelës janë:

- Emër, mbiemër.
- Adresa e postës elektronike
- Pozicioni {Student}
- Data
- Firma

Shënim- Studenti nuk e plotëson këtë zë, pasi e plotëson Përfaqësuesi i Universitetit të Huaj.

Shembull i Tabelës së Plotësuar

Commitment					
By signing this document, the student, the Sending Institution and the Receiving Institution confirm that they approve the Learning Agreement and that they will comply with all the arrangements agreed by all parties. Sending and Receiving Institutions undertake to apply all the principles of the Erasmus Charter for Higher Education relating to mobility for studies (or the principles agreed in the Inter-Institutional Agreement for institutions located in Partner Countries). The Beneficiary Institution and the student should also commit to what is set out in the Erasmus+ grant agreement. The Receiving Institution confirms that the educational components listed in Table A are in line with its course catalogue and should be available to the student. The Sending Institution commits to recognise all the credits or equivalent units gained at the Receiving Institution for the successfully completed educational components and to count them towards the student's degree as described in Table B. Any exceptions to this rule are documented in an annex of this Learning Agreement and agreed by all parties. The student and the Receiving Institution will communicate to the Sending Institution any problems or changes regarding the study programme, responsible persons and/or study period.					
Commitment	Name	Email	Position	Date	Signature
Student	Lara Gjata	laragjata@gmail.com	Student	10.23.2018	
Responsible person ^{xxi} at the Sending Institution	Alma Idrizi	alma.idrizi@umed.edu.al	Pro Rector for International Relations	10.23.2018	
Responsible person at the Receiving Institution ^{xxii}					

Ky është i gjithë informacioni që ju nevojitet për të aplikuar në thirrjet e shpallura nga Universiteti i Mjekësisë.

Tabelat e tjera në Marrëveshjen e Studimit kanë të bëjnë me ndryshime që mund të kryhen gjatë periudhës së shkëmbimit sikundër dhe me të dhëna që kanë të bëjnë me përfundimin e periudhës së shkëmbimit.

Këto tabela nuk plotësohen nga studenti, por nga Universiteti i Mjekësisë, në bashkëpunim me Universitetin e Huaj.
